REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
Njësia Org. KMIMI
Nr. i Prot. 3032
Nr. Faqeve 1
Data: 19.05.2015
PRISHTINË

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Infrastrukturës*
*Ministarstvo Infrastrukture*
*Ministry of Infrastructure*

Nr. 3032/2015
Datë: 19.05.2015

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, Në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në Nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe nenin 38 paragrafi 6 të Rregullore së Punës së Qeverisë nr.09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 1209.2011) nxjerr:

## V E N D I M

**I.** Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 2004/1 mbi Organin e Inspektoratit, i nënshkruar më datë 20.02.2004.

**II.** Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/4 mbi Drejtorinë e Rrugëve, i nënshkruar më datë 08.09.2003.

**III.** Shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/1 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/4 mbi Drejtorinë e Rrugëve, i nënshkruar më datë 25.04.2007.

## A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë shfuqizohen Udhëzimi Administrativ nr. 2004/1 mbi Organin e Inspektoratit, Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/4 mbi Drejtorinë e Rrugëve dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/1 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimi Administrativ Nr. 2003/4 mbi Drejtorinë e Rrugëve, me qenë se këto dispozita tani janë të rregulluara me Rregulloren (QRK) Nr. 38/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Infrastrukturës, me të cilën tani funksionojnë si Departamente.

**Lutfi Zharku**

**Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
PRISHTINË

**Vendimi i dërgohet:**

*Kabinetit të Ministrit;*
*Sekretarit të Përgjithshëm;*
*Zyrës Ligjore të Kryeministrit;*
*Departamentit Ligjor;*
*Departamentit të Inspektimit;*
*Departamentit të Menaxhimit të Rrugëve;*
*Arkivit.*